

NJOFTIM PËR SHTYP

Parlamenti shqiptar dhe Prezenca e OSBE-së organizojnë një konferencë për rolin e deputetëve në proceset e integritit evropian

TIRANË, 8 maj 2008 – Roli i rëndësishëm i Parlamentit në procesin e Integritit Evropian do të diskutohet në një konferencë nesër, organizuar nga Parlamenti shqiptar, Prezenca e OSBE-së dhe Lëvizja Evropiane Shqipëria.

Temat kryesore të diskutimit do të jenë: drejtimi i procesit nga institucionet vendore, mënyrat e ndërtimit të një dialogu sistematik me grupet e interesit mbi sfidat e integritit evropian dhe politikat e BE-së që promovojnë demokratizimin dhe shtetin e së drejtës. Do të theksohet në mënyrë të veçantë roli i parlamentarëve në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian.

Ndër folësit kryesorë do të jenë Kryetarja e Kuvendit Jozefina Topalli, Kryeministri Sali Berisha, Ministri i Punëve të Jashtme Lulzim Basha, Kryetari i Partisë Socialiste Edi Rama, Ilir Meta, Kryetar i Komisionit Parlamentar për Integritin Evropian, si edhe Ambasadori Helmuth Lohan, Kryetari i Delegacionit të Komisionit Evropian në Tiranë, dhe Ambasadori Robert Bosch, Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Ministrat, deputetët dhe grupet e shoqërisë civile do të diskutojnë rreth sfidave të integritit të Shqipërisë.

Kjo konferencë zhvillohet në Ditën Evropiane dhe është pjesë e një serie aktiviteteve të organizuara për të shënuar javën evropiane në Shqipëri.

Gazetarët janë të ftuar ta ndjekin këtë veprimtari, e cila fillon në orën 10:00, ditën e Premte, më 9 maj, te *Tirana International Hotel*, Bulevardi Zogu I.